



AKT -THEMELIMI I SHOQËRISË ANONIME "KLUBI FUTBOLLIT ADRIATIKU MAMURRAS" SH.A

Në Mamurras, sot më dt 20.06.2008, Bashkia "Mamurras" duke patur parasysh; Masivitetin e sportit dhe veçanërisht të futbollit në popullatën brenda juridiksionit të saj;

Me qëllim organizimin e sportit të futbollit me themelimin e shoqëris "Klubit Futbollit Mamurras" sh.a;

T'ju afrojë qytetarëve të saj, persona fizik e juridik mundësin juridike, organizative dhe ekonomike për të kontribuar në zhvillimin e sportit në përgjithësi dhe të futbollit në veçanti;

Synimin e pjesëmarrjes në të gjitha veprimtaritë që organizon Federata Shqiptare e Futbollit (F.SH.F.) si dhe ato të organizmave ndërkombëtare FIFA dhe UEFA për të cilat deklararon se njeh dhe pranon autoritetin e tyre;

Vendimit të këshillit bashkiak Nr. 32 Datë 20.06.2008;

Referencën të ligjit 8184 datë 28.03.1996; ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ligjin NR. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit" vendosi:

Neni 1

Krijimin e shoqërisë tregtare shtetërore e llojit Anonime "Klubi Futbollit Adriatiku Mamurras" sh.a.

Shoqëria është person juridik i të drejtës shqiptare dhe vepron si e tillë në çdo rrethanë.

Emri i shoqërisë tregtare është shoqëria tregtare "Klubi Futbollit Adriatiku Mamurras" sh.a.

Shoqëria ka selinë e saj në qytetin e Mamurrasit në adresën Bashkia Mamurras. Shoqëria ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj pa afat të caktuar.

Neni 2

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë "Klubi Futbollit Adriatiku Mamurras" sh.a. do të jetë:

Organizimi, drejtimi, financimi dhe administrimi i Klubit të Futbollit Mamurras i cili do të quhet "ADRIATIKU" (K.F.Adriatiku Mamurras), organizimi i aktiviteteve sportive, pjesëmarrje në aktivitete të organizuara F.SH.F.; Fifa dhe UEFA. Brenda dhe jashtë vendit, Import Eksport dhe tregtim të artikujve sportivë.

Neni 3

Organet Drejtuese

Asambleja e aksionarve. (vendimet e aksionarit të vetëm, për sa kohë është i tillë janë të barazvlershem me ato të asambles së aksionerve);

Këshilli Administrativ;


Administratori;

Neni 4

Përberja e Organëve Drejtuese

Asambleja e Aksionerve përbëhet nga pjesëmarrja e aksionarve themelues.

Bashkia Mamurras si aksionare e vetme duke qënë se është person juridik do të përfaqësohet në këtë asamble nga kryetari i saj Z. Ded Ndreca. Me miratimin e këtij akti themelimi Kryetari i Bashkisë, Z. Ded Ndreca gëzon të gjitha të drejtat e përfaqësimit në asamble të aksionarve dhe nuk ka nevoj për autorizim tjetër të mevonshëm. Kjo e drejtë i njihet dhe në rast se Bashkia nuk do të jetë zotëruese e 100% të aksioneve (në rast të tjetërsimit të një pjese të aksioneve). Në çdo rast kryetari i bashkisë do të jetë përfaqësues i aksioneve të zotëruara nga Bashkia Mamurras. Vendimet e aksionarit të vetëm, për sa kohë është i tillë janë të barazvlershem me ato të asambles së aksionerve.



Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga një numër i plotëpjestueshëm me tre. Antarët e këshillit mbikqyrës emërohen dhe shkarkohen nga asambleja e aksionerve sipas rregullave të këtij akti themelimi si dhe statutit të saj.

Këshilli i parë mbikqyrës do të përbëhet nga tre anëtarë:

Administratori do të jete një person fizik.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 lekë dhe do të derdhet si kontribut në para nga aksionari themelues në një llogari bankare të hapur për këtë qëllim mbas rregjistrimit të shoqërisë.

Kapitali themeltar është i ndarë në 2.000 aksione me vlerë nominale 1 000 lekë/aksion dhe zotërohet 100% nga aksioneri themelues Bashkia Mamurras:

Mbas rregjistrimit të shoqërisë pranë QKR, mbi bazën e vendimit të asamblesë së aksionarve kapitali themeltar mund të shtohet si në kontribute në para ashtu dhe nëpërmjet kontributit në natyre duke respektuar ligjin dhe rregullate e këtij statuti.

Neni 6

Ndërtimi organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar, në baze të statutit dhe këtij akti themelimi.

Ngarkohet z. Ded Ndreca që në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë të nënshkruaj aktet e themelimit të kësaj shoqërie si dhe statusin e saj.

Shoqëria fillon veprimtarinë me nënshkrimin dhe miratimin e dokumentave të saj themelues.

**Për aksionarin themelues
Bashkia Mamurras
Ded NDRËCA**

(Kryetar i Bashkisë)

Ded Ndreca

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOAMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1095 Rep.

VERTETIM - NENSHKRIMI

Sot, ne daten 01 Korrik 2008(dymije e tete), dite e Marte, para meje Noterit Ylli Çela, anetar i Dhomes se Noterise Tirane, me seli ne Tirane, Rruga "Mine Peza" Pall.3, Ap.25, u paraqit Z.Ded NDRECA, i biri i Markut dhe i Dranes, lindur ne Mamurras me 19.10.1965, banues ne Mamurras, me funksionin e Kryetarit te Bashkise Mamurras, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Pasaporten Nr.Z 0802675, i cili me deklaroi se jashte kesaj zyre ka perpiluar Aktin e Themelimit te Shoqerise Anonime "Klubi Futbollit Adriatiku Mamurras"Sh.a., te cilin me vullnetin e saj te lire dhe te plote e nenshkruan pa verejtje ne pranine time dhe une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI

Ylli ÇELA

NOTER YLLI ÇELA
CEL: 0692047471

PULLE TAKSE

